

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

DREJTORIA ARSIMORE RAJONALE E QARKUT TIRANË
SHKOLLA 9-VJEÇARE KATUND I RI

Nr: 78 Prot

Tiranë, më 22 / 04 / 2015

NJOFTIM PËR KONKURIM PËR VEND TË LIRE PUNE

Shkolla 9 - Vjeçare Katund i Ri, Tiranë, në zbatim të Ligjit Nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të Udhëzimit Nr.35, datë 30.09.2014 "Për procedurat e lëvizjes paralele, emërimit dhe të largimit nga puna të mësuesit në institucionin publik të arsimit parauniversitar", shpall njoftimin e kërkesave për konkurim, për vendin e lirë të punës në pozicionin **Mësues i Edukimit Fizik** në :

1. Shkolla 9-Vjeçare Katund i Ri, Tiranë. Të gjithë mësuesit e këtij profili Edukim Fizik, të interesuar për këtë pozicion pune (**Mësues te Edukim Fizik**), duhet të paraqesin pranë drejtorisë së Shkollës 9-Vjeçare Katund i Ri, Tiranë, dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) Diplomë të ciklit të dytë të studimeve universitare, sipas përcaktimeve të nenit 57 të Ligjit Nr.69/2012, datë 21.06.2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", (fotokopje e noterizuar e diplomës dhe listës së notave të shkollës së lartë).
- b) CV dhe kopje të dëshmimeve apo dokumente që vërtetojnë pohimet në CV (sipas modelit të përcaktuar në shtojcën Nr.1, bashkëlidhur Udhëzimit Nr.35, datë 30.09.2014).
- c) Tabelën e të dhënave për aplikant (Sipas modelit të përcaktuar në shtojcën Nr. 2, bashkëlidhur Udhëzimit Nr.35, datë 30.09.2014).
- d) Raportin mjeko - ligjor.
- e) Dëshminë e masave disiplinore në fuqi në ngarkim të tij. (Nëse nuk ka e deklaron me shkrim që nuk ka).
- f) Dëshminë e penalitetit, të lëshuar jo më herët se tre muaj para datës së aplikimit.

Dorëzimi i dokumentacionit të aplikimit për konkurim, do të bëhet pranë drejtorisë së Shkollës 9-Vjeçare Katund i Ri, Tiranë, me adresë Rruga "Katund i Ri " , cdo ditë nga ora 08:⁰⁰ – 14:⁰⁰.

Afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit të aplikimit për konkurim, do të jetë data 30 / 04 / 2015 ora 14.00.

Dokumentacioni për aplikim dorëzohet në drejtorinë e Shkollës 9-Vjeçare Katund i Ri , Tiranë, me procesverbal dorëzimi.

DREJTOR
ARJAN GJOKA

